

Raporti Kombetar mbi Strategjine Rajonale te zbatimit (Regional - Implementation Strategy RIS) te Planit Nderkombetar te Madridit per Moshimin (the Madrid International Plan of Action on Ageing -MIPAA) ne Shqiperi gjate periudhes 2012-16

Permbledhje ekzekutive

Approximately 500 to 700 words (1-1.5 A4 pages, single-spaced).

Please provide an executive summary according to the structure below:

☑ Methods used for this report; in particular, details of the bottom-up participatory approach used, if any

☑ Brief review of national progress in fulfilling (or lagging behind) the commitments of MIPAA/RIS. Include **three to five major achievements** since 2012 and **three to five important aspects to be improved in the future**

Ky eshte raporti i dyte qe ka paraqitur Shqiperia lidhur me Planin Nderkombetar te Madridit mbi Moshimin. Per here te pare eshte bere e mundur nje shkalle e larte e pjesemarrjes nga burime dhe aktore te ndryshem. Pervet perdorimit te nje numri raportesh dhe studimesh mbi moshimin, jane ftuar te kontribojne me informacione dhe pervoja gjate zbatimit te MIPAA/RIS me teper se 20 aktore qeveritare dhe jo qeveritare. Instrumenti per aktoret i pergatitur nga sekretariati i UNECE u perkthye ne shqip dhe u diskutua ne dy linja komunikimi me pjesemarrsesit; nje linje iu dedikua Ministrive dhe institucioneve publike dhe tjetra organizatave jo qeveritare

Plakja e popullates se Shqiperise karakterizohet nga nje tranzicion demografik relativisht i vone dhe nje nivel i larte i emigracionit.

Shqiperia ka punuar ne shume fusha qe prej Konferences se Vjenes dhe qeveria e saj i ka vendosur ceshtjet e moshimit mes prioriteteve te saj. Nje shembull i mire i kesaj eshte perfshirja e ceshtjeve te moshimit ne dokumentin politik baze te vendit sic eshte Strategjia per zhvillim dhe integrim 2015-2020. Shembuj te tjere jane projekt- ligje te reja si ai i strehimit social, i cili perfshin ne menyre specifike te moshuarit.

Reforma e Pensioneve e parashikuara ne Programin e ri qeveritar ne 2012 dhe e zbatuar ne 2014-2015, e drejtuar nga Ministria e Ceshtjeve Sociale, eshte me rendesi te vecante per kete periudhe raportimi. Ai merr ne konsiderate moshimin e popullates shqiptare dhe pritet te ndikojte si personat qe aktualisht jane mbi 65 vjec ashtu edhe ata qe jane ende me te rinj. Harmonizimi i sistemit te pensioneve, rritja e moshes se pensionit dhe e viteve te kontributit, si dhe futja e pensioneve sociale sherbejne si baze per stabilizimin kontrates nder-breznore ne te ardhmen, nderkohe qe pergatisin shoqerine per rritjen graduale te te moshuarve te ngelur jashte sistemit. Krijimi i pensioneve sociale permes ketij ligji eshte edhe nje pergjigje, mes te tjerash e nevojese se shprehur nga grupet e shoqerise civile gjate procesit te gjate per adoptimin e nje ligji 'per statusin e pensionistit'. Qe prej vitit 2015 jane me shume se 5000 te moshuar qe po perfitojne tashme prej pensioneve sociale. Ky pension eshte i vogel por mund te ndihmoje shume te

moshuar, sidomos grate ne zonat rurale, te qendrojne jashte varferise. Vleresohet t'i kushtojte vendit rreth 0.025% te PPB.

Reforma shendetesore po e zhvendos systemin shendetesore nga fokusimi kryesishtne problemet tradicionale shendetesore si ato te nenes dhe femijes, drejt perballimit te semundjeve kronike ne rritje dhe permiresimit te aksesit te te gjitha kategorive te popullates ne sherbimet e duhura te kujdesit shendetesor. Eshte pranuar tashme se moshimi i shoqerise i jep parandalimit dhe kapjes se hereshme nje rol thelbesor ne rritjen e cilesise se jetes, duke frenuar ne te njejten kohe rritjen e kostove mjekesore. Programi i ri i kontrollit shendetesor baze eshte nje investim per cilesi te permiresuar te jetes ne vitet e mevoneshme te adulteve, nderkohe qe eshte duke u shtrire per te perfshire gjithashtu te moshuarit e sotem, duke permiresuar aksesin e tyre ne sherbimet baze shendetesore. Nderkohe, ka nje permiresim te qarte te ndergjegjesimit per perfshirjen e sherbimeve detyrave dhe burimeve specifike dedikuar kujdesit per te moshuarit. Paketa e re e sherbimeve e vitit 2014 per tu ofruar ne qendrat shendetesore, perfshin 11 sherbime te diagnozes dhe ndjekjes si dhe 15 sherbime te parandalimit dhe keshillimit per te moshuarit. Mes nderhyrjeve te percaktuara per here te pare jane sherbimet ne shtepi dhe komunitet, asistenca psikologjike dhe monitorimi i abuzimit te mundshem. Ne vend qe te perqendrohet ne sherbime te shtrenjta te geriatrise, shoqatat e profesionisteve dhe Ministria e Shendetesise jane duke konverguar ne integrimin e sherbimeve per personat e moshuar ne sistemet ekzistuese paresore dhe dytesore, duke permiresuar standartet dhe kualifikimin e profesionisteve te shendetit. Gjithashtu, dy vendime te reja te Keshillit te Ministrave te aprovuara ne 2014 do te kene ndikim te drejteperdrejte ne aksesin e pensionisteve ne kujdesin e specializuar mjekesor

Reforma e re e sherbimeve sociale, e cila eshte ne process, (nje draft ligj eshte pergatitur tashme dhe eshte nen diskutim), pritet te rrise aksesin ne sherbime te cilesise se mire per te moshuarit.

Qe prej vitit 2012 verehet nje rritje e rendesishme ne studimet kombetare dhe nderkombetare mbi moshimin si dhe publikimeve mbi moshimin ne Shqiperi. 'Plakja e popullsise: situata e te moshuarve ne Shqiperi' eshte raporti i pare i ketij lloji i botuar ne vitin 2015 nga INSTAT. Studimi Nderkombetar mbi Mobilitetin dhe Moshimin-IMIAS, nje studim me ndjekje i kryer ne nje kohorte te moshuarish gjate 2012-2016, ka beret te mundur publikimin e nje numri artikujsh mbi moshimin ne revista nderkombetare, duke vleresuar mes te tjerash per here te pare format e ndryshme te abuzimit (fizik, psikologjik dhe financiar) mes te moshuarve ne Shqiperi.

Per vitet ne vijim, ne Shqiperi, koordinimi me i pershtatshem dhe me sistematik mes i nsticioneve ne fushen e moshimit, ngelet nje sfide per tu adresuar, duke identifikuar qasjet apo menytrat me te pershtatshme per vendin. Pervoja e vendeve te tjera e keshillave kombetare te moshimit mund te jete nje nga modelt per t'u marre ne konsiderate.

Institucionet shteterore do te duhet te gjejne ne vijimesi menyra te ndryshme per te mbeshtetur te gjitha format e kujdesit sidomos ato te bazuara ne familje dhe ne komunitet, si dhe te ndihmojne rregullimin me te mire te profesionit te kujdestarve per te moshuarit. Kjo do te ndihmonte me tej 'moshimin ne vendndodhje' (ageing in place), duke u lejuar te moshuarve te vijojne te jetojne per sa me gjate te jete e mundur ne mjedisin dhe komunitetin e tyre.

Se fundi, duke marre parasysh pjesemarrjen relativisht te ulet te te moshuarve ne jeten sociale, do te duhet t'u jepet rendesi me e madhe perpjekjeve nga ana e te gjitha aktoreve per te nxitur kete pjesemarrje. Kjo mund te arrihet permes mbeshtetjes se aktiviteteve ne terren nga ana e grupeve

ekzistuese te te moshuarve apo e rrjeteve fillimisht ne zonat urbane, per tu zgjeruar dora dores ne zonat rurale duke pasur nje vemendje te vecante per grate e moshuara.

Informacion i pergjithshem

1. Country name

Republic of Albania

3. Name and contact details of official national focal point on ageing

Merita Xhafa,

General Director of Social Policies

Ministry of Social welfare

2. Name and contact details of the author(s) of the report

Alban Ylli

Tirana University of Medicine

Albanian Association of Geriatry Gerontology

Merita Xhafa

Anisa Proda

Ministria e Ceshtjeve Sociale

4. Name, reference, and date of adoption or status of preparation of national strategy, action plan or similar policy dokument on ageing (please attach relevant dokument in the annex).

Policy dokument of social inclusion 2016-2020. January 2016. Published in issue 20 of Oficial Gazette 2016.

PJESA I

1. Situata kombetare moshimit

Approximately 500 words (1 A4 page, single-spaced, excluding annexes).

1. Presentation of **demographic indicators** that could help better understand the country's development regarding the issues discussed

2. Presentation of **key quantitative social and economic indicators** and features that may help to bring into focus the issues treated and to permit quantitative analysis

3. Brief **description of the social, economic and political situation**, which may help to understand the context in which ageing-related issues are dealt with in your country.

Shqiperia eshte nje nga vendet e fundit ne Europe qe po perjeton efektet e moshimit te popullates. Proporcioni i popullates mbi 65 vjec u rrit nga 5% ne 1990, ne 11% ne censusin e fundit (INSTAT-2011) dhe vijon te rritet. Ka me shume se 370 000 te persona mbi 65 vjec ne vend, krahasuar me rreth 230 000 ne vitin 2001. Renia e shpejte e nivelit te lindshmerise se bashku me rritjen e jetegjatesise mesatare kane gene ne baze te ketij transformimi te demografise se Shqiperise. Jetegjatesia mesatare per periudhen 2010-2014 eshte 17.2 ne moshen 65 vjec dhe 7 vjet ne moshen 80 vjec, nje permiresim i lehte krahasuar me periudhen 2005-2009.

Emigracioni eshte nje faktor tjeter i rendesishem, i cili nuk eshte duke ndikuar vetem ne forcimit te efektit te shtimit relative te te moshuarve ne shoqeri, por gjithashtu edhe ne dobesimin e rrjeteve mbeshtetese tradicionale te ofruara nga familjet. Emigrimi i anetareve te me te rinj ne familje eshte vecanerisht i larte ne Shqiperi: nje ne dy familje ka te pakten nje anetar te emigruar brenda apo jashte vendit (Studimi Demografik dhe Shendetsore 2009). Rreth 3 milione shqiptare jetojne ne Shqiperi, nderkohe qe rreth 1.5 milione jetojne jashte.

Studimi IMIAS (International Mobility in Ageing Study) ne Tirane tregon se rreth 10% e te moshuarve jetojne krejtesisht vetem nderkohe qe 45% jetojne vetem me bashkeshorten apo bashkeshortin. Megjithate, brezat e rinj, qe e lene me heret shtepine e prinderve dhe punojne jashte ngelen nje burim potencial mbeshtetje per prinderit e moshuar te ngelur vetem, permes dergesave ne para dhe ne momente problemesh serioze shendetsore duke mbuluar nderhyrje te shtrenja mjekesore.

Sipas LSMS 2012, nje studim i INSTAT, rreth 10% e te moshuarve ishin te te varfer dhe nuk mund te perballonin standartet baze te jeteses. 'Thellesia e varferise' e te moshuarve te vafer ishte mesatarisht jo shume e madhe cka do te thote se me pak mjete shume te moshuar mund te ngrihen ne statusin e jo te varferit. Telefonat celulare jane perhapur masivisht gjate viteve te fundit dhe shumica derrmuese e te moshuarve zoterojne nje, por kompiuterat dhe lidhja me internetin ngelen te kufizuara ne nje pakice te moshuarish, cka mund te perbeje nje barriere ne aksesin e duhur ne informacion. Ne menyre te ngjashme, megjithese perdorimi i makinave eshte ne rritje, vetem nje ne pese te moshuar zoterojne nje, nje kufizim tjeter i mundshem i aksesit fizik ne zonat ku transporti publik eshte i manget. Rreth 30% e te moshuarve shqiptare jetojne ne blloqe apartamentesh, ku nje kufizim i rendesishem i mobilitetit per 80% te tyre eshte mungesa e ashensorit. Shumica derrmuese ose 93% e te moshuarve ka akses ne banjo te pershtatshme, por vetem 76% e kane kete brenda shtepise. Ky eshte sidomos nje problem ne fshat.

Sistemi i pensioneve ne Shqiperi, megjithese mbulon pothuaj gjithe te moshuarit, perballej me sfida te lidhura me demografine dhe ekonomine. Kishte vetem 1.1 kontribues per nje marres pensioni ne 2013. Raporti i vartesis se moshimit poshuaj u dyfishua prej 8.6% ne 1989 ne 16.7% ne vitin 2011. Ne 2030, ky raport do te jete dyfishuar serish per te arritur ne 32.9%. Vec kesaj, vetem 58.4% e personave ne moshe pune ishin kontribues ne vitin 2012. Ligji i fundit i pensioneve, i cili ka futur per here te pare pensionet sociale adreson disa nga keto sfida duke rritur perqindjen kontributit ngapagesa, duke incentivuar kontributet etj.

Studime te koheve te fundit (IMIAs) tregojne nivele relativisht te larta te semundjeve kronike, depresionit dhe dizabilitetit tek te moshuarit. Si IMIAS ashtu edhe LSMS konfirmojne se dizabiliteti, semundjet kronike dhe depresioni jane vazhdimisht me te larta tek gerate e moshuara krahasuar me burrat. Aksesit ne sherbimet shendetesore paresore eshte relativisht i mire, nderkohe qe sigurimet shendetesore mbulojne te gjitha medikamentet dhe procedurat baze, me perjashtim te kujdesit per dhembet dhe atij per syte. Shqiperia shpenzon rreth 100\$ ne kosto shendetesore per cdo person ne vit.

Rritja ekonomike e Shqiperise pothuaj u ndal ne 2012, por me pas ekonomia ka treguar shenja te permiresimit dhe rritja e projektuar per 2016 eshte 3.2%. Papunesia e te rinjve dhe ekonomia informale ngelen nje shqetesim qe mund ta kercenoje systemin e pensioneve apo skemat e tjera sociale, megjithese gjate tre veteve te fundit, punesimi formal eshte ne rritje.

2. Metoda

Up to 500 words (1 A4 page, single-spaced, excluding annexes).

Quantitative information can be taken from ongoing and new studies on ageing, both cross-sectional (assessing the impact of policies across several sectors) and longitudinal (observing a specific policy impact over a period of time).

Qualitative information can be obtained through a **bottom-up participatory approach or other available qualitative data from recent research** (preferably undertaken since 2012). If member States wish to conduct new qualitative research for the purpose of this report, the participatory approach may be a suitable tool, as it calls for the involvement of older persons in assessing the impact of policy actions on the quality of their lives.

In general this section should refer to **interactions with the different stakeholders** – such as ministries, regional and lokal authorities, non-governmental organizations (NGOs), the private sector, social partners, academia and organizations representing the interests of older persons and of young persons - especially in the context of intergenerational relations – and on how these interactions contributed to the report.

Per te pergatitur kete raport u perdoren nje numer dokumentash dhe analizash te publikuara apo te papublikuara, si dhe disa artikuj shkencore. Ketu eshte nje liste e tyre:

‘Moshimi i popullates: situata e te moshuarve ne Shqiperi’ nje raport i publikuar ne 2015 nga INSTAT me mbeshtetjen e UNFPA dhe Kooperacionit Zviceran.

‘Profili social i te moshuarve ne Shqiperi’ nje raport i studimit te kryer ne 2015 nga Qendra Kombetare per Studime Sociale-NCSS, nje OJQ, e mbeshtetur nga UNFPA.

Raportet dhe artikujt shkencore te bazuar ne ‘International Mobility In Ageing Study’, nje studim me ndjekje i kryer ne Tirane gjate 2012-2016 nga Shoqata Shqiptare e Geriatrie Gerontologjise -AAGG, nje shoqate profesionistesh , mbeshtetur nga Universiteti i Montrealit.

‘Kapacitetet lidhur me avokatine per te moshuarit ne Shqiperi’ nje vleresim mbi kapacitetet, pervojen dhe burimet tek shoqatat e shoqerise civile ne Shqiperi, e kryer nga AAGG ne 2016, me mbeshtetje te Bashkimit European.

‘Planifikimi strategjik per Rrjetin ‘Movement of Organizations Supporting Healthy Ageing-MOSHA’ nje analize e prioriteteve dhe planeve per shoqatat e te moshuarve dhe partnered e tyre (institucione qeveritare, media etj) i perkatitur ne 2016 nga vete rrjeti.

Artikuj dhe raporte mbi sociologjine dhe ekonomine e moshimit te publikuara ne revisten Demografia, nje botim periodic i Shoqates se Demografave dhe i mbeshtetur nga UNFPA.

Gjithashtu janë përdorur të gjitha dokumentet e politikave dhe ligjet lidhur me moshimin, të përgatitura gjatë periudhës në vlerësim. Këtu përfshihen, 'Strategjia e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale 2015-2020', 'Strategjia Kombëtare për zhvillim dhe integrim' 2015-2020', 'Dokumenti i politikave të pensioneve 2014', 'Ligji no 104/2014 mbi disa ndryshime në sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë dhe disa projekt ligje, rregullore, paketa shërbimesh dhe Vendime të Këshillit të Ministrave.

Për të siguruar një qasje nga poshtë lart të të gjithë aktorëve, u realizuan dy takime ndërsa një paketë e dokumentave të përmbledhur u perkthye dhe u shpërnda me email. Paketa përmbante udhëzues për aktorët me objektivat, angazhimet dhe masat bazë të parashikuara nga MIPAA/RIS të përgatitur nga UNECE për vlerësimin e tretë 2012-2017, një përmbledhje e parimeve dhe procesit të lidhur me MIPAA dhe vlerësimeve të mëparshme si dhe një përmbledhje të gjetjeve dhe rekomandimeve të një raporti të përgatitur nga një mision fakt mbledhës i UNDESA/DSPD (Department of Economic and Social Affairs and Division for Social Policy and Development) në Shqipëri në 2011.

Me shumë se 20 institucione publike dhe organizata të shoqërisë civile në kuadër të rrjetit MOSHA u ftuan të kontribuojnë me informacione dhe përvoja të lidhura me MIPAA/RIS në Shqipëri gjatë 2012-2016. MOSHA (Movement of Organizations Supporting Healthy Ageing) është një instrument koordinues që përmbledh shoqata të moshuarish, shoqata profesionistësh dhe grupe të tjera të shoqërisë civile me interes në çështjet e moshimit. Në rrjet marrin pjesë në mënyrë të rregullt ministri, qendra të shërbimeve publike dhe institucione akademike. Përfqesuesit e organizatave dhe të institucioneve u kontaktuan me email apo në takime të vecanta për të diskutuar çështjet të lidhura me progresin e MIPAA/RIS në Shqipëri dhe të shpjegojnë detaje të politikave të ndërtuara apo të masave e aktiviteteve të zbatuara. Një listë e institucioneve dhe organizatave të tjera të ftuara të marrin pjesë në proces është paraqitur me poshtë:

Institucione qeveritare

- 1. Ministria e Çështjeve Sociale dhe Rinisë*
- 2. Ministria e Shëndetësisë*
- 3. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor*
- 4. Instituti i Sigurimeve Shoqërore*
- 5. Zyra e Avokatit të Popullit*
- 6. INSTAT*
- 7. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale*
- 8. Instituti i Shëndetit Publik*
- 9. Bashkia e Tiranës*
- 10. Qender Ditore në Tiranë*

Organizata/sindikata të të moshuarve/pensionistëve

- 11. Unioni i Përgjithshëm i Pensionistëve të Shqipërisë*
- 12. Unioni Kombëtar i Pensionistëve të Pleqërisë*
- 13. Shoqata për Integrimin e Pensionistëve*
- 14. Organizata e Veteranëve të Luftës*

Shoqata Profesionistësh

15. Shoqata Shqiptare e Geriatrie gerontologise

16. Shoqata e Demografeve te Shqiperise

17. Shoqata e Gazetareve te Shendetit dhe ceshtjeve Sociale

OJF te tjera

18. Albanian Society for all Ages Association (ASAG)

19. Albanian Institute of Sociology

20. Association for Life Quality (ALQU)

21. Albanian Community Health Organization (ACHO)

22. Resource center for Family Issues

Pjesa II

1. Masat dhe progresi ne zbatim te MIPAA/RIS

Approximately 900-1,200 words for each of the four main goals of the Vienna Declaration, (2-3 A4 pages, single-spaced, excluding annexes).

This part of the report is expected to be divided into subsections. You should organize your reporting in terms of the four main goals of the Vienna Declaration and the corresponding commitments of RIS that are most relevant to your country (table)

Seksioni 1.1

Synimi 1: Inkurajimi i zgjatjes se jetes ne pune dhe ruajtja e aftesise per pune

Disa nga angazhimet te lidhura me synimin e pare te MIPAA/RIS jane angazhimi 1 (te harmonizohet moshimi me gjithe politikat e tjera ne menyre qe te vendosen shoqerite dhe ekonomite ne harmoni me ndryshmet demografike), angazhimi 2 (sigurimi i integritit dhe pjesemarrjes se te moshuarve ne shoqeri) angazhimi 3 (promovimi i rritjes ekonomike te qendrueshme dhe te barabarte ne pergjigje te moshimit te popullates) dhe angazhimi 5 (aftesimi i tregjeve te punes per t'ju pergjigjur pasojave ekonomike dhe sociale te moshimit te popullates)

Strategjia e re per zhvillim dhe integrim 2015-2020, e cila eshte dokumenti kryesor politik i zhvillimit te vendit dhe shenon udhen e Shqiperise drejt integritit me Bashkimin Europian, nje si burimin me te rendesishem te vendit njerezit dhe shoqerine shqiptare si e nje e tere. Sigurimet shoqerore, te fokusuar kryesisht ne ekuilibrimin e punes, kontributeve shoqerore dhe pensioneve, jane nje nga komponentet kryesore (se bashku me arsimimin, shendetesine, punesimin etj) te zhvillimit njerezor dhe kohezionit shoqeror, sic pershkruhen ne Strategji. Ne te njejten strategji, jane nenvizuar sfidat lidhur me moshimin e shoqerise Shqiptare, nderkohe qe te moshuarit e izoluar jane perfshire ne kategorite e grupeve vulnerabel

Eshte shume shpejt per te matur efekte te zbatimit te strategjise se re, por duhet theksuar se ajo ngelet nje shembull i mire i perfshirjes (mainstreaming) se moshimit ne dokumentat kryesore politike ne vendit.

Gjate vitit 2015, nen drejtimin e Ministrise se Ceshtjeve Sociale dhe Rinise, me pjesemarrjen e shume aktoreve te tjere, perfshire partneret e shoqerise civile dhe me mbeshtetjen e UNDP, u pergatit Dokumenti i Politikave te Perfshirjes Sociale 2016-2020. Ky dokument u publikua ne numrin e 20te te Gazetes Zyrtare 2016. Ne Shkurt 2016 u aprovua plani i veprimit te strategjise. Kjo strategji eshte ne harmoni dhe merr mjaft principe dhe targete nga Strategjia Europiane kunder varferise dhe perjashtimit social. Strategjia thekson monitorimin dhe raportimin e masave te zbatuara. Moshja eshte perfshire aty si nje faktor risk per tu marre parasysh nderkohe qe 'grate e moshuara' jane nje kategori specifike e pershkruar si prioritet. Ne vijim te dokumentit politik, Ministria e Ceshtjeve Sociale ka pergatitur nje strategji tjeter me te detajuar, Strategjine e Mbrojtjes Sociale, ku pershkruahen nderhyrje dhe masa per integrimin e grupeve vulnerabel ne Shqiperi.

Per te promovuar pjesemarrjen e drejte shoqerore dhe te drejtat njerezore per te moshuarit (mes grupeve te tjera te konsideruara si vulnerabel), strategjia parashikon sherbime te asistences ligjore falas. Politikat e strehimit social jane nje nga kolonat e strategjise. Aty nenvizohet se strehimi i sigurte dhe i mbrojtur eshte nje nga te drejtat baze te njeriut. Qeveria e Shqiperise duhet te mbeshtese kete te drejte permes programeve specifike, perfshi apartamentet sociale qera, shtepite me kosto te ulet, dhe toke publike per ndertim. Vec tyre parashikohen masa te tjera, te tilla si, subvencioni i qerases, apo i kredise bankare, grante te vogla, grante te menjehershme etj. Te moshuarit jane nje grup me prioritet ne kete kontekst. Me aprovimin e strategjise ka filluar puna mbi nje ligj mbi strehimin social. Eshte pergatitur drafti nen drejtimin e Ministrise se Infrastruktures dhe Planifikimit te Territorit dhe parashikohet te perfundohej brenda vitit.

Strategjia e mbrojtjes sociale ka futur per here te pare nje kornize te standartuar me indikatore te pershkruar ne detaje lidhur me monitorimin e perjashtimit social per grupe specifike. Keto indikatore do te sherbejne per te matur perparimin e strategjise drejt perfshirjes me te mire sociale. Lidhur me te moshuarit jane mbi 30 tregues, perfshire nivelin e te moshuarve ne risk per te rrene ne varferi, te ardhurat mesatare relative (50% dhe 70%), pabarazite ne te ardhura, riskun e thellimit te varferise, nivelin e punesimit per ata qe jane 55-64 vjec, nivelin e varesise, jetegjatesine mesatare per moshate ndryshme, nivelin e banesave me probleme etj. Per shume tregues, kerkohet disagregimi sipas seksit dhe gjeografise. Treguesit lejojne, vec te tjerash, monitorimin e nivelit te perfshirjes se pjesetareve te komunitet rom ne skemat e pensioneve.

Per te promovuar dhe mbeshtetur stilin e shendeteshem te jeteses dhe mireqenien ne pune, parandalimin dhe kontrollin e semundjeve kronike, Ministria e Shendetsise ka nisur ne fillim te vitit 2015, per here te pare ne vend, nje program te masiv, bazuar ne sherbimet e kujdesit shendetesor paresor. Programi, i cili eshte i financuar nga buxheti i shtetit dhe pa pagese per te gjitha personat mbi 40 vjec, ofron check up shendetsore te pervitshem permes testeve, ekzaminimeve dhe intervistave lidhur me kapjen e hershme te sjelljes me rezik dhe problemeve te fshehta shendetsore. Ai ofron ne te njejten kohe keshilla profesionale dhe ndjekje ne hallkat e tjera te sistemit. Programi synon te ruaje shendetin mendor dhe fizik si dhe mobilitetin, e me gjase nje kufizim te kostove mjekesore ne moshe te shtyre. Programi eshte skicuar ne menyre korrekte, duke projektuar perfitimet shendetsore tek te moshuarit sidomos, por fillimisht kishte debate mes grupeve te te moshuarve lidhur me kufizimin e moshes se siperme te kategorise per t'u perfshire. Perfaqesuesit e rrjetit MOSHA bene advokati per perfshirjen e personave mbi 65 vjec ne program me argumentin e te drejtave dhe barazise se sherbimeve. Pas disa diskutimeve me zv. ministrin e shendetsise, kjo kerkese eshte pranuar formalisht. Nje projekt Vendim i Keshillit te Ministrave eshte pergatitur nga ana e Ministrise se Shendetesise dhe pritet qe brenda vitit 2016 te finalizohen detajet e zgjerimit te programit. Dhjetra mijera te moshuar pritet te perfitojne drejtperdrejte prej tij cdo vit.

Ministria e Shendetesise ne bashkepunim me Organizaten Boterore te Shendetesise dhe organizatat e shpqrise civile, ia dedikuan ditin boterore te shendetit ne 7 prill 2012 Moshimit dhe Shendetit. Nje fushate massive me pjesemarrjen e qindar te moshuarve dhe te rinjve si dhe me nje mbulim te larte mediatik u realizuane Tirane. Fushata promovoi jetesen e shendeteshme pergjate te gjitha jetes, per te shpetuar jete, per te mbrojtur shendetin dhe per te parandaluar dizabilitetin dhe dhimbjen ne moshen e trete. Mesazhet e tjera te perdoruara mbuluan ceshtje te tilla si 'kapja e hereshme e semundjeve, parandalimi dhe kujdesi permiresojne mireqenien mes te moshuarve'. Prej vitit 2012, cdo vit, Instituti i

Shendetit Publik dhe rrjeti MOSHA kane organizuar fushata ne nje shkalle me te vogel mbi moshimin aktiv dhe te shendetshem. Te dhena te koheve te fundit deshmojne per nje renie te vazhdueshme te duhanpirjes mes grave dhe burrave te moshuar ne Shqiperi.

Tranzicioni nga puna ne pension eshte i menjehershem dhe i ashper ne Shqiperi. Ligji ne menyre strikte kerkon daljen ne pension ne menyre tipike te burrave 65 vjec dhe grave 60 vjec. Sipas studimit IMIAS krahasimisht pak shqiptare te moshuar vijojne te punojne kundrejt pageses pas daljes ne pension. Nje perpjekje e pare per ta bere tranzicionin nga puna ne pension me fleksibel, ne menyre qe te personat e moshuar te mund te qendrojne me gjate te punesuar, sipas nevojave dhe aspiratave te tyre, eshte masa e parashikuar ne ligjin per arsimin e larte ne fuqi nga shtatori i 2015. Nga viti 2016, ne vend te daljes automatike ne pension permes vendimit unilateral te punedhenesit, profesoret e universiteteve lejohen te negociojne duke mundesuar me shume fleksibilitet dhe perfshirje me te gjate ne pune. Ne nje shembull tjetër fleksibiliteti ne daljen ne pension, ndodh qe here pas here mesues apo mjekte te moshuar te perfshihen serish ne pune pas daljes ne pension aty ku ka nevoja, sidomos ne qytetet e vogla te vendit.

Seksioni 1.2

Synimi 2: Promovimi i pjesemarrjes, perfshirja sociale dhe jo-diskriminimi i te moshuarve

Vec angazhimeve 1, 2 e 8 (te permendur ne seksionin 1.1) ka dy angzhime te tjera te lidhura me synimin 2; angazhimi 4 (adaptimi i sistemeve te mbrojtjes sociale ne pergjigje te ndryshimeve demografike dhe pasojat e tyre sociale e ekonomike) dhe angazhimi 6 (promovimi i te mesuarit gjate gjithë jetes dhe adaptimi i sistemit arsimor ne pergjigje te ndryshimit te kushteve demografike, sociale e ekonomike). Disa politika relevante, programe apo masa te tjera te ndermarra ne Shqiperi, lidhur me keto angazhime, jane pershkruar me poshte:

Strategjia e re kombetare per zhvillim dhe integrim, e permendur me siper, eshte vetem njera ne listen e disa politikave, strategjive dhe ligjeve, te cilat kane hedhur bazat e nje reforme historike, duke u zbatuar qe prej vitit 2014 ne Shqiperi, e cila synon te adaptoje sistemet kombetare te pensioneve ne ndryshimet demografike dhe te adresojte sfidat serioze te verejtura, perfshire paqendrueshmerine , inbalancat e kontributeve me perfitimet, diferencat urban rural dhe nje proporcion ne rritje (megjithese ende i vogel) i te moshuarve pa asnje pension.

Objektivi i qeverise se Shqiperise eshte t'i beje sistemet e pensioneve te qendrueshem ne kohe dhe te besueshem per brezat e ardhshem, duke permbushur ne te njejtën kohe synimin kryesor te garantimit te te ardhurave te mjaftueshme per te moshuarit. Kjo do te arrihet kryesisht permes rritjes se mases se kontributeve dhe proporcionit te atyre qe kontribojne, koordinimit mes gjithë agjencive qe luftojne informalitetin, rritjes se numrit te viteve te kontributit nga 35 ne 2015, 37 ne 2020, rritjes se lehte te moshes se pensionit (per te arritur 61 per femrat ne vitin 2020) dhe unifikimin e skemes per pensione rurale dhe urbane nga viti 2018. Dy komponente te rendesishem te reformes jane; se pari, krijimi per here te pare, i pensioneve sociale (ne efekt e nisur me ligjin e ri) per te moshuarit qe nuk kane asnje

burim tjetër të ardhurash dhe së dyti, sigurimi i pensioneve për popullatat emigruese të Shqipërisë përmes marrëveshjeve me vende të tjera të rajonit, sidomos me shtete të Bashkimit Europian. Reforma është drejtuar nga Ministria e Çështjeve Sociale dhe krijimi i pensioneve sociale përmes këtij ligji është edhe një përgjigje, mes të tjerash, e nevojës së shprehur nga grupet e shoqërisë civile gjatë procesit të gjatë për adoptimin e një ligji 'për statusin e pensionistit'.

Që prej vitit 2015, shumë të moshuar në Shqipëri kanë filluar të përfitojnë prej pensioneve sociale. Për të marrë këtë pension një person duhet të jetë të paktën 70 vjeç, të jetë resident në Shqipëri dhe të mos ketë të ardhura të tjera. Kategoritë tipike të personave përfitues janë gratë që nuk kanë qenë të punësuar, por janë marrë vetëm me punë shtepie të papaguar, të papunët afatgjatë apo ata që nuk kanë qenë fare të punësuar gjatë jetës së tyre, personat që kanë jetuar në zonat rurale të vetë punësuar në fermat e vogla por me moshe nuk mund ta perdorin token si me burim të ardhurash dhe personat e kthyer nga emigrimi pa historinë e nevojshme të punësimit që do t'i lejonte të përfitonin prej një pensioni të detyrueshem. Pensioni social është relativisht i vogël (rreth 8000 leke ose pothuaj sa gjysma e pensionit mesatar urban në Shqipëri) por mund të ndihmojë shumë të moshuar të qëndrojnë jashtë varferisë, sidomos gratë në zonat rurale. Me tëper se 5000 të moshuar janë duke përfituar prej tij. Vlerësohet se kostoja e këtij pensioni për sistemin e ri të pensioneve është rreth 450 000 000 Leke ose 0.025% e PPB.

Ngelen ende sfida në arritjen e suksesit afatgjatë të kerkuar të politikave të reja, sidomos atyre të lidhura e rritjen e kontributeve. Nga ana tjetër me tëper mund të bëhet në të ardhmen për të mbështetur tregjet e punës për t'u adaptuar me një shoqëri që po plakët.

Vetëm 5-10 vjet më parë, të dhenat mbi moshimin në Shqipëri ishin mjaft të mangëta ose pothuaj nuk ekzistonin fare. Kështu, studimet kombëtare shëndetsore dhe demografike të viteve 2002 dhe 2009 fokusoheshin vetëm tek popullatat e adulteve të rinj 15-49 vjeç. Pothuaj nuk ekzistonin botimet kombëtare mbi situatën demografike, shëndetsore, sociale dhe ekonomike të të moshuarve. Një nga rekomandimet e rëndësishme të raportit të përgatitur nga misioni faktmbledhës i UNDESA/DSPD në Shqipëri në 2011, ishte zhvillimi i kapaciteteve për kerkim, mbledhje sistematike të të dhenave dhe analizat përkatëse mbi moshimin në Shqipëri. Që prej vitit 2010, ka një rritje të rëndësishme të studimeve dhe publikimeve kombëtare e ndërkombëtare mbi këtë çështje. Kjo rritje ka një lidhje të drejtperdrejtë me intensifikimin e aktivitetit të organizatave profesionale e joqeveritare dhe rritjen e ndergjegjesimit tek aktorët shtetërorë si edhe mbështetjen e nga ana e organizatave të UN në këtë fushë.

Botimi më i rëndësishëm është Plakja e popullatës: situata e të moshuarve në Shqipëri' një raport i publikuar në vitin 2015 nga INSTAT me mbështetjen e UNFPA dhe Swiss Cooperation. Në të analizohen të dhenat me të fundit të shpërndara për kategoritë moshore, bazuar në censusin kombëtar dhe disa studime të tjera. Disa analiza të tjera me të thelluara në fusha me specifike janë bazuar në 'International Mobility in Ageing Study-IMIAS', një studim me ndjekje të kryer në një kampion personash 65-75 vjeç në Tiranë gjatë 2012-2016 nga AAGG dhe Universiteti i Tiranës në bashkëpunim me Universitetin e Montrealit. Një numer artikujsh shkencorë mbi moshimin e kanë vendosur Shqipërinë në hartën globale të kerkimit në këtë fushë. Për herë të parë, ky studim bëri të mundur vlerësimin e formave të ndryshme të abuzimit (fizik, psikologjik dhe financiar) tek të moshuarit në Shqipëri. Gjithashtu janë kryer edhe studime të tjera; një prej tyre është 'Profili social i të moshuarve në Shqipëri' raportin e të cilit e perfundoi në 2015 Qendra Kombëtare për Studime Sociale-NCSS, një shoqatë jo qeveritare, embeshtetur nga UNFPA. Perodiku 'Demografia' një botim i Shoqatës së Demografëve, e mbështetur nga UNFPA, që prej 2012 i ka dedikuar me tëper hapësirë artikujve raporteve dhe analizave mbi çështjet e moshimit.

Per te promovuar aksesin gjate gjithë jetes ne arsim dhe trajnimin e te moshuarve, rrjeti MOSHA dhe Unioni i Pensionistëve të Pleqerisë kanë zbatuar projekte lokale ne 2012, 2014 dhe 2015; ne 2012 AAGG dhe MOSHA ne kuader te nje projekti te financuar nga Bashkimi Europian organizuan nje kurs mbi perdorimin e kompiuterit, internetit, postes elektronike dhe mediave sociale per nje grup prej rreth 30 te moshuarish. Vec kesaj, rrjeti organizoi nje numer seminaresh me perfaqesues te organizatave te te moshuarve mbi tema te tilla si asistenca ligjore, menaxhimi i projekteve dhe avokatia. Ne nje nga keto seminare perfaqesues nga Tirana Legal Aid Society bene prezantime mbi kornizen ekzistuese ligjore dhe i inkurajuan te moshuarit te perdornin te gjitha mundesite perfshi asistencen ligjore dhe informacionin per te menjanuar abuzimin dhe per siguruar dinjitetin e te drejtat e tyre njerezore. Gjate 2014 dhe 2015 Unioni i Pensionistëve të Pleqerisë ka organizuar nje seri leksionesh mbi semundjet dhe shendetin ne bashkepunim me Universitetin e Tiranës.

Qe prej vitit 2012, shoqatat e pensionistëve dhe shoqata te tjera me interes mbi ceshtjet e moshimit shpesh ne bashkepunim me pushtetin lokal dhe qendror, kanë organizuar fushata sistematike per te promovuar perfshirjen e te moshuarve ne jeten politike dhe sociale. Fushatat rreth dates 1 tetor kanë qene fokusuar kryesisht ne aktivitete avokatie per te lehtesuar pjesemarrjen ne proceset e vendimmarrjes ne te gjitha nivelet, si ne menyre te drejteperdrejte (duke inkurajuar qindra te moshuar aktiviste te behen pjese e marshimeve apo mbledhje massive publike) apo permes organizatave te shoqerise civile dhe rrjeteve. Ne 2013 u organizua nje mbledhje me komisionin parlamentar te ceshtjeve sociale e shendetesore nga rrjeti MOSHA per te shtyre perpara draft-ligjin e mbiquajtur ‘te statusit te pensionistëve’. Drafti nuk u shderrua ne ligj, por me qeverine e re te ardhur ne pushtet pas zgjedhjeve ndonje element i ketij projekt ligji u perfshi ne ligjin e ri te pensioneve. Organizatat e shoqerise civile (ASAG dhe Shoqata per integrimin te moshuarve) ne nje fushate gjate tetorit te vitit 2015 organizuan takime me aktore shtetore perfshi Avokatin e Popullit ne vazhdim te avokatise per statusin e pensionistëve. Fushatat e 7 prillit poshuaj cdo vit kanë qene fokusuar ne inkurajimin e shoqatave te te moshuarve per t’u perfshire ne avokati per sherbime te pershtatshme shendetesore dhe ndergjegjesim per shendetin e te moshuarve. Si rezultat e ketyre fushatave, Ministria e Shendetesise eshte duke adaptuar kete vit programin e saj te ri te kontrollit baze shendetesor. Aktivitetet kanë qene pjese e fushave nderkombetare ‘Moshë Kerkon Veprim’. Projekti i ri i rrjetit MOSHA, i mbeshtetur nga BE, i filluar ne vitin 2016 si pjese nje rrjeti shoqatash te vendeve te Ballkanit Perendimor synon mes te tjerash, te punoje me median mbi ndertimin e imazheve jo-diskriminuese te te moshuarve dhe promovimin e informacionit rreth moshimit si nje faze natyrale e zhvillimit individual. Kane filluar tashme aktivitetet per te perfshire te moshuarit ne procesin e planifikimit, zbatimit dhe vleresimit te fushatave kombetare mediatike.

Administrata e re e Bashkise se Tiranës pas zgjedhjeve te 2013, ka nisur nje proces te perfshirjes se te moshuarve ne diskutimet per zhvillimin e planeve te Bashkise. Nje keshill qytetar i te moshuarve eshte formuar me pjesemarrjen e anetarve te shoqatave te pensionistëve dhe aktiviste te tjere te moshuar. Mbledhja e pare e keshillit me Kryetarin e bashkise u organizua ne vitin 2015. Kryetari i bashkise deklaroi idete e tij per nje qytet miqesor per personat ‘8-80 vjec’. Vec kesaj, plani i ri urban i Tiranës ka percaktuar standarte qe i bejne ndertesat e reja me te pershtatshme per te moshuarit. Ngelet per tu monitoruar ne praktike sesi do te zbatohen ne realitet detyrimet qe cdo ndertese e re duhet te te jete e aksesueshme per te moshuarit apo per personat me aftesi te kufizuara

Megjithese ka shembuj te mire qe ilustrone pjesemarrjen e te moshuarve ne jeten politike dhe sociale, ne 2012, studimi IMIAS tregonte se vetem nje proporcion i vogel i te moshuarve ne Shqiperi eshte pjese e nje shoqate apo klubi. Kjo eshte vecanerisht e vertete per grate Shqiptare te moshuara

Gjate 2016 AAGG kreu nje analize lidhur me profilin e te moshuarve ne shoqerine civile dhe mundesite e perfshirjes se shoqatave ne avokati dhe bashkepunim me institucionet shteterore. Ajo deshmon se pritshmerite e shume te moshuarve, bazuar ne traditen dhe kohet e mepareshme, jane per nje qeveri qe merr persiper me shume per ta. Shume prej tyre jane kritike per inefficiencen dhe mungesen e respektit nga institucionet shteterore. Megjithate numrin e madh te deklaruar te anetareve, keto shoqata duket te kene kapacitete te dobeta te avokatis. Institucionet shteterore nga ana tjeter, nenvizojne prioritetet konkurruese (femijet, te rinjte, komunitetet rome etj), rigjeditetin e institucioneve publike dhe nevojën per te deleguar me shume pergjegjesi ne nje shoqeri demokratike. Perfaqesuesit e institucioneve permendin se individet qe me probleme komunikimi mund te ndikojne ne uljen e besimit reciprok. Disa shoqata shprehen se ka shume mundesi te pashfrytezuara ne vete komunitetet dhe per bashkepunim mes qeverive, organizatave dhe bile edhe bizneseve. Te moshuarit shihen nga shumica e anetareve te rrjetit si nje grup me kategori te ndryshme; aty ka jo vetem anetare vulnerabel dhe te izoluar te shoqerise por edhe kontribues aktive me pervojë dhe njohuri per te mbeshtetur dhe ndryshuar gjerat. Ka nevojë per t'i lidhur keto grupe me karakteristika te ndryshme qe ekzistojne mes vete te moshuarve ne Shqiperi.

Seksioni 1.3

Synimi 3: Promovimi dhe ruajtja e dinjitetit, shendetit, dhe autonomise tek te moshuarit

Angazhimi kryesor i lidhur me synimin 3 ne MIPAA/RIS eshte angazhimi 7: perpjekje per te siguruar cilesine e jetes ne te gjitha moshat dhe per te ruajtur autonome perfshire shendetin dhe mireqenien

Per te permbushur kete angazhim, Shqiperia ka pergatitur disa rregullime ligjore dhe paketa te standrtizuara sherbimesh. Pas 6 muajsh pune ne nje grup teknik, te ngritur me urdher te Ministrit te Shendetesise dhe te mbeshtetur nga UNFPA, ne 2014 u aprovua paketa e re e sherbimeve per t'u ofruar ne te gjitha qendrat e kujdesit shendetsor paresor ne Shqiperi . Paketa eshte miratuar nga nje marreveshje e perbashket e Ministrit te Shendetesise dhe Drejtorit te Fondit te Sigurimeve te Kujdesit te Detyrueshem Shendetesor. Ne pakete eshte perfshire nje seksion i dedikuar (seksioni 5) ' kujdesi shendetsor per te moshuarit'. Ajo percakton qendren shendetesore 'miqesore' per te moshuarit dhe kerkon adaptimin e aftesive te personelit shendetesor ne baze te nevojave te te moshuarve (mbi 65 vjec). Synimi i sherbimeve eshte te reduktojne komplikimet dhe ruajne shendetin. Paketa permban 11 sherbime te diagnozes dhe ndjekjes si dhe 15 sherbime te parandalimit dhe keshillimit per te moshuarit. Mes nderhyrjeve te percaktuara per here te pare jane ato te kujdesit ne shtepi dhe ne komunitet, asistenca psikologjike dhe monitorimi i abuzimit te mundshem.

Gjate vitit 2014 u aprovuan dy rregullime ligjore te rendesishme nga Keshilli i I Ministrave te Shqiperise. Keto rregullime kane ndikim te drejteperdrejte ne aksesin e pensionisteve ne kujdesin e specializuar shendetesor. VKM e pare (No:308 date 21.05.2014) garanton ofrimin e nje numri paketash sherbimesh te

kujdesit spitalor per pensionistet. Sherbimet perfshijne ekzaminime te specializuara kardiologjike, kirurgji te zemres, transplant te veshkave, dialize dhe transplant veshkash per insuficiencen e veshkave, transplant koklear per humbjen e degjimit. Keto sherbime mund te merren ne spitalet publike dhe private me kontrate me fondin e sigurimeve shendetsore pa kosto te drejteperdrejta nga moshuarit. Vendimi tjetër i Keshillit të Ministrave i të njetit vit (No:955, date 29.12.2014) i perjashton pensionistet nga cdo pagese e drejteperdrejte per barnat e listes. Karta e re e shendetit permban numrin unik individual dhe numrin e sigurimit te detyrueshem. Ajo shperndahet falas per te moshuarit dhe nuk nevojitet te rinovohet cdo vit. Ajo ka filluar te lehtesoje aksesin e te moshuarve ne sherbimet paresore apo ato spitalore duke minimizuar burokracine. Analiza e Fondit te Sigurimeve Shendetesore per periudhen 2012-2016 demonstron se 70% e recetave totale dhe 45-50% e kostos totale te barnave shkon per te moshuarit.

Sherbimet e reja te mamografise te filluara per here te pare ne Shqiperi nga janari 2015 jane duke permiresuar ne menyre te ndjeshme aksesin ne sherbimet e parandalimit per kanceret per grate mbi 50 vjec ne qytetet e vogla dhe fshatrat ne Shqiperi. Pothuaj 8000 gra kane perfituar tashme prej ketyre sherbimeve.

Pasi 'Kujdesi Geriatrik' u fut si nje lende e re e vecante ne programin e Fakultetit te Infermierise dhe Teknologjise Mjekesore, ne 2012 ai u perfshi ne programin e mesimdhenies se Fakultetit te ri te Shendetit Publik, pjese e Universitetit Mjekesor te Tiranës.

Duhet pasur parasysh se megjithese disa protokolle klinike ekzistojne ne praktiken e kujdesit shendetsor paresor lidhur me kujdesin per te moshuarit, doktoret dhe infermieret kane pak trajnim ne lidhje kete fushe dhe ne nje studim kualitativ te vitit 2013, te moshuarit shpesh ankohen lidhur me komunikimin e papershtatshem dhe probleme te tjera etike me punonjesit shendetesore.

Nevoja per me shume qendra ditore apo rezidenciale per te moshuarit ne Shqiperi, gjate 5 viteve te fundit eshte duke u perballuar pjeserisht nga nje rritje e institucioneve te kujdesit publike dhe jo publike. Verehet nje prirje ne rritje e ndermarjeve te kategorizuara si 'biznes social' te sherbimeve per te moshuarit; mes 18 qendrave rezidenciale, 12 jane jo publike dhe mes 15 qendrave ditore, 13 jane gjithashtu jo publike. Ka gjithsej 1400 te moshuar gjithsej ne qendrat rezidenciale ne Shqiperi. Vec kesaj, qeverite lokale prane bashkive jane duke u perpjekur te luajne nje rol me te madh dhe jane ngritur nderkohe 9 qendra multidisiplinare, ku te moshuarit vulnerabel mund te gjejne nje infrastrukture te pershtatshme dhe sherbime te tjera (perfshi ushqim te pershtatshem, kafe, gazeta dhe mundesi per shoqerizim) cka ndihmon per te t'u perfshire ne jeten e perditeshme me dinjitet.

Reforma e sherbimeve sociale eshte ne proces dhe nje draft ligj eshte pergatitur nga Ministria e Ceshtjeve Sociale. Ky projekt ligj, rregullon ofrimin e sherbimeve nga palet e treta, duke futur procedura te qarta te prokurimit dhe standarte te cilesise. Vec kesaj, reforma synon ne deinstitutionalizimin e te moshuarve me nevoja te vecanta, duke ndertuar sherbime alternative, perfshi ketu modele te bazuara ne komunitet apo ne familje.

Perfaqesuesit e organizatave te te moshuarve jane konsultuar ne te gjitha stadet e pergatitjes se ligjit te ri te kujdesit paliativ; se pari ne Ministrine e Shendetesise ku u pergatit drafti dhe me vone ne komisionin parlamentar (1 tetor 2014) para aprovimit perfundimtar ne parlament (16 tetor te te njetit vit). Per here te pare tashme ne Shqiperi ekziston nje baze ligjore per te ruajtur dinjitetin dhe autonomine e pacienteve, pa paragjykime, dhe per te promovuar cilesine e jetes pa dhembje deri ne fund. Ligji i njejte gjitha llojet e iniciativave per te ofruar kujdes paliativ, perfshire OJQ dhe familjet dhe kerkon prej Ministrise se Shendetesise t'i mbeshtese ato ne forma te ndryshme. Ne funksion te zbatimit te ligjit, 5

sherbime te reja jane organizuar ne nivel te kujdesit spitalor dhe paresor ne Tirane dhe disa qytete te tjera.

Nderkohe qe legjislacioni eshte duke u permiresuar dhe barrierat ne aksesin e sherbimeve shendetsore jane duke u adresuar, ngelen boshllqe te rendesishme ne kapacitetet profesionale apo ne rrjete e vullnetareve qe mbeshtetin te moshuarit. Ne kete kontekst, dy projekte, pjese e programeve jo qeveritare dhe qeveritare jane nje model i mire ne fushen e ofrimit te sherbimeve me te pershtatshme per te moshuarit i cili nevojitet te mbeshtet dhe zgjerohet :

Caritas Albania, nje OJQ, qe prej tetorit te vitit 2012 eshte pjese e nje rrjeti nderkombetar ne projektin rajonal 'NET-AGE', nje iniciative e mbeshtetur prej programit IPA (Bashkimi Europian). Kujdesi ne shtepi per te moshuarit eshte nje komponent kryesor i projektit dhe eshte pilotuar ne Tirane nga nje ekip multidisiplinar prej 5 punonjesish (doktor, infermier dhe sanitare). Ata jane kujdesur tashme per shume persona te moshuar te semure, jo autonome apo te vetmuar. Projekti ka promovuar perfshirjen vullnetare nga persona te rinj apo te moshuar te cilet jane mobilizuar ne mbeshtetje te individeve vulnerabel ne komunitetet e tyre.

Nje projekt tjetër synon te ofroje nje pergjigje me afatgjate ne pergatitjen e kujdestareve profesionale per te moshuarit ne nevoje. Ende, kujdestaret te cilet punojne ne institucione rezidenciale per te moshuarit, me perjashtim te disa infermiereve, nuk kane kualifikimin e duhur. Kujdesi i papershtatshem dhe abuzimi jane rezultat i kujdesit jo profesional dhe abuzimit te raportuar ne ndonje media. Ne Kamez, prane Tiranes, nje shkolle e re e specializuar profesionale per trajnimitin e kujdestareve eshte duke ofruar prej vitit 2013 nje program 4 vjecar kualifikimi per kujdestare per te moshuarit, ne bashkepunim me Ministrine e Ceshtjeve Sociale dhe GIZ, nje agjensi gjermane. 50% e trajnimit ne program eshte e perbere nga praktika ne mjedise ku ofrohet kujdes per te moshuarit. 'Sanus-infermieri mobile', nje OJQ e kujdestareve profesionale, ka krijuar ne vitin 2015 nje rrjet te organizatave dhe profesionisteve te specializuar ne kujdesin per te moshuarit dhe po punon ne bashkepunim me Ministrine e Ceshtjeve Sociale dhe Urdherin e Infermiereve per te rregulluar dhe mbeshtetur me mire profesionin e kujdestareve per te moshuarit.

Demencat priten te jene nje problem ne rritje, qe kercenojne cilesine e jetes te te moshuarve ne Shqiperi duke i vene gjithashtu familjet e tyre para nje presioni te madh. Ende nuk ka struktura specifike te dedikuara dhe as aktivitete sistematike ne kete fushe, nderkohe qe shoqeria ka nevoje te ndergjegjesohet me mire lidhur me problemin dhe faktin se shume individe te moshuar dhe familje vuajne ne heshtje dhe nuk marrin mbeshtetjen e duhur.

Gjate tre viteve te fundit eshte verejtur nje permiresim substancial ne kuader te programit qeveritar 'Rilindja Urbane' per infrastrukturen. Permes granteve te qeverise jane duke u financuar programme infrastrukture te paraqitura nga bashkite dhe 126 projekte jane e duke bere nderkohnje diference pozitive ne shume qytete dhe fshatra te Shqiperise. Keto projekte jane duke ofruar zona publike me te pershtatshme per jetesen per te moshuarit (trotuare te permiresuar, zona per kembesoret, ndricim publik i permiresuar, parqe e lulishte publike etj). Megjithate infrastruktura ne Shqiperi ngelet nje shqetesim dhe kostot per transporti publik konsiderohen nga shume te moshuar si nje barriere per te arritur sherbimet ose thjesht per te qene aktive, per levizur ne qytet, e per t'u shoqerizuar me persona te tjere.

Pas disa aktiviteteve te avokatise me Bashkine e Tiranes, ka plane per te ofruar transport falas per disa kategori me ne nevoje te moshuarish.

Seksioni 1.4

Synimi 4: Ruajtja dhe promovimi i solidaritetit nder-breznor

Vec angazhimeve 1, 4, dhe 8, te cile jane pershkruar me siper, i lidhur me synimin nr 4 te MIPAA/RIS eshte edhe angazhimi 9: mbeshtetja e familjeve qe ofrojne kujdes per te moshuarit dhe promovimi i solidaritetit nderbreznor dhe mes breznor (mes vete te moshuarve)

Progresi i Shqiperise ne arritjen e ketij synim dhe permbushja e angazhime te lidhura me te, do te mund te ndaheshin ne tre dimensione: a) perfshirja e moshimit dhe sanksionimi i solidaritetit nder breznor ne ligje dhe politika, b) ndertimi i instrumentave publike per ti zbatuar keto politika ne praktike dhe c) krijimi i mjediseve te pershtatshme per inciativa nga shoqeria civile dhe komunitetet.

- a) Shqiperia ne vijimesi ben perpjekje te perfshije moshimin ne politikat dhe legjislacionin kombetar, duke adoptuar ne te njejten kohe strategjite e mbrojtjes sociale me prirjet e moshimit te popullates. Qe ne kushtetuten e Shqiperise (artikulli 59), eshte sanksionuar roli i shtetit lidhur me te moshuarit. Strategjia e fundit e mbrojtjes dhe perfshirjes sociale 2015-2020 ka integruar ceshtjet e moshimit dhe ka vendosur targete per tu monitoruar. Ligje te tjera Te sapo aprovuara apo ne process, dhe te pershkruara ne seksione te tjera te ketij raporti (ligji i sigurimeve shoqerore, vendimet e Keshillit te Ministrave mbi kujdesin shendetesor etj, projekt ligji i strehimit social etj) sanksionojne principet e solidaritetit nder-breznor ne shoqeri.*
- b) Ministria e Ceshtjeve Sociale dhe Ministria e Shendetesise jane dy ministrite kryesore qe kanalizojne fonde publike dhe burime te tjera ne institucione dhe sherbimete dedikuara per te moshuarit si dhe qe vendosin standartet e i monitorojne ato. Sherbimet e kujdesit shendetesor per te moshuarit jane duke u bere me pershtatshme dhe me te aksesueshme per te moshuarit qe prej vitit 2012, per arsye te rregullimeve te reja ligjore dhe paketave te reja te sherbimeve ne kujdesin paresor dhe ne kujdesin spitalor. Ne fushen e kujdesit social, ka nje prirje te delegimit te me shume pergjegjesive nga qeveria qendrore ne nivelin e qeverive vendore; shumica e 61 bashkive te reja te Shqiperise, kane disa struktura dhe burime per monitorimin e vulnerabilitetit te qytetareve te tyre te moshuar dhe mund te ofrojne deri diku mbeshtetje per ta. Megjithate, ngelen shume boshlleqe dhe duket se burimet ne nivel vendor nuk jane te mjaftueshme per te mbuluar te gjitha nevojat konkurruese lidhur me shume grupe sociale ne rezik, dhe personat e moshuar vulnerable nuk jane prioriteti me i madh mes tyre.*
- c) Megjithese nderhyrjet e ndermarra nga organizatat e shoqerise civile ende ngelen te pakta dhe jane perqendruar kryesisht ne kryeqytetet dhe qytete te tjera te medha te vendit, verehet nje prirje per me shume koordinim nderkohe qe disa aktivitete me vlere te kryera prej tyre mund te sherbejne si shembuj positive per t'u pergjithesuar dhe per t'u bere me sistematike.*

Shumica e fushatave te rritjes se ndergjegjesimit te organizuara nga rrjeti i organizatave te te moshuarve kane arritur te bashkojne aktivistet e moshuar nga njera ane me studentet e rinj ne anen tjetere. Rasti me i fundit ishte aktiviteti i organizuar me studentet e Fakultetit te Mjekesise dhe rreth 100 te moshuar aktiviste nga Shoqata e Pensionisteve te Shqiperise ne date 6 Qershor 2016 me rastin e dites boterore te zemres dhe nisjes se nje projekti te ri te rrjetit.

Disa shembuj te tjere jane listuar me poshte:

Nje nga objektivat me te rendesishem te projektit ne kuader te (Instrument for Pre Accession-IPA) 'Dialogu i Organizatave te Shoqerise Civile mbi problemet e te Moshuarve ne Ballkanin Perendimor, i cili eshte zbatuar ne Shqiperi, sebashku me vendet e tjera fqinje te ballkanit Perendimor, ishte ndertimi dhe fuqizimi i grupeve vete-ndihmese. Keto grupe synonin te fuqizonin dhe motivonin te moshuarit te zgjidhnin ne menyre te pavaruar problemet e tyre. Nen kete projekt rreth 13 grupe vete ndihmese u krijuan duke angazhuar rreth 100 te moshuar aktiviste. Vec kesaj, eshte promovuar vullnetarizmi ne komunitete me perfshirjen e dhjetra studenteve qe punonin se bashku me puinonjesit sociale te Bashkise ne identifikimin e te moshuarve te izoluar dhe ofrimin e disa sherbimeve te thjeshta per ta.

Projekti i Caritas Albania, i permendur me siper, ka mbeshtetur ne te njejten menyre, punen ne komunitet nga ana e grupeve te profersionisteve, duke ndertuar modele te kujdesit ne shtepi per rreth 50 te moshuar te vetmuar apo te semure.

Rrjeti i organizatave dhe profesionisteve me fokus kujdesin per te moshuarit, i katalizuar nga 'Sanus-infermeria mobile' eshte nje tjetere model ku deshmohet bashkepunimi mes profesionisteve te rinj dhe te moshuarve te cilet synojne se bashku te njejtin objektivi; te promovojne mbeshtetjen per familjet e personave te moshuar ne nevoje, duke krijuar ne te njejten kohe me shume mundesi per pune per profesionistet e rinjte kualifikuar ne kujdestarine per te moshuarit.

Nderkohe qe shteti, nuk mund te luaje nje rol te madh ne adresimin e nevojave rekreacionale te te moshuarve, me perjashtim te ndertimit te parqeve publike dhe mbeshtetjes se klubeve ditore, ka nje numer shembujsh te sukseshem te bashkepunimit te drejteperdrejte te organizatave te pensionisteve me ndermarrjet private, te cilat ofrojne falas mjedise dhe ushqime per festa shoqerore apo udhetim falas ne atraksionet turisitike brenda vendit. Qe prej vitit 2012, cdo vit, te kater organizatat kryesore te pensionisteve ne Shqiperi raportojne te kene realizuar nje sere aktivitetesh rekreative per anetaret e tyre, te mbeshtetur nga partnere private.

Vec fushatave te pervitshme te ndergjegjesimit publik rreth perfshirjes se te moshuarve dhe solidaritetit nder-breznor, gjate vitit 2014, u organizuan dy konferenca te rendesishme; e para, ne Prill ishte nje Konferenca nderkombetare mbi moshimin (Burning needs of Ageing in Albanian society) e organizuar nga ASAG, AAGG, dhe bashkia e Tiranës ne bashkepunim me European Federation of Older People – EURAG, nje organizate jo fitimprureses nderkombetare dhe me pjesemarrjen e 14 vendeve Europiane. UNFPA ndihmoi ne mbeshtetjen e conferences. Se dyti, ne nentor, u organizua kongresi i kujdestareve per te moshuarit, ku marren pjese 25 shoqata dhe institucione. Organizatore ishin Sanus dhe GIZ. Solidariteti i shoqerise per te moshuarit u prek ne prezantime dhe diskutime ne te dy konferencat.

Ceshtjet gjinore jane duke u bere nje teme e rendesishme ne Shqiperi. Ekziston nje ligj dhe nje strategji per barazine gjinore. Dhe rezultatet konkrete nuk mungojne: numri i grave anetare te parlamentit u rrit

nga 16.4% ne 2009 ne 20.7% ne 2014; numri i grave ne keshillat bashkiake u rrit nga 12.2% ne 2011 ne 35% in 2015. Grate kryetare bashkie nga 4.6% ne 2011 shkuan ne 14,7% ne 2015. Megjithate, te dhenat rreth problemeve gjinore tek te moshuarit shqiptare ngelen sporadike. Per here te pare nga vitit 2012 ekzistojne te dhena te prodhuara nga studime lokale rreth dhunes ndaj grave te moshuara. IMIAS demonstroi se 6% e te moshuarave ne Tirane kane pesuar dhune fizike nga partneri, nderkohe qe 12% prej tyre kane pesuar dhune psikologjike. Shifra te ngjashme raportohen nga grate e moshuara rreth abuzimit nga anetaret e familjes. Nje problem tjetër i dukshëm është diferenca ne pjesëmarrjen e grave te moshuara krahasuar me burrat e moshuar ne Shqiperi; nje studim kualitativ i vitit 2013 raporton se jane rreth 5 here me shume burra se sa gra qe marrin pjese ne shoqata, frekuentojne qendra ditore dhe grupe te tjera komunitare. Ne pergjigje te kesaj situata, institucionet shteterore jane duke bere perpjekje per perfshirjen e ceshtjeve gjinore se bashku me moshimin ne politikat qeveritare, nderkohe qe disa grupe te shoqerise civile synojne te fokusohen me shume tek grate e moshuara ne fushatat dhe projektet e tyre.

Seksioni 1.5

Bashkepunimi rajonal

Angazhimi 10 ka te beje me promovimin dhe zbatimin e ndjekjen e RIS permes kooperimit rajonal

Qeveria e Shqiperise ka bashkepunuar me agjensite e OKB gjate procesit te plotesimit te angazhimeve te MIPAA/RIS dhe arritjes se synimeve te saj. Ne vijim te nje misioni te perbashket te Department of Economic and Social Affairs (DESA) dhe Division for Social Policy and Development (DSPD) ne 2011 ne Shqiperi, pas kerkeses nga ana e Ministrise se Ceshtjeve Sociale dhe ne bashkepunim me UNFPA ne Tirane, DESA u perfshi ne mbeshtetje te Qeverise Shqiptare me rekomandime dhe zbatim te drejteperdrejte te aktiviteteve specifike ne vend, te tilla si organizimi ne vitin 2012 i nje seminari me institucionet publike dhe organizatat e shoqerise civile rreth draft ligjit per te moshuarit ('statusi i pensionisteve'). Me vone, DESA inkurajoi dhe asistoi ne skicimin e nje projekt propozimi lidhur me forcimin e kapaciteteve te shoqerise civile dhe permiresimin e ndergjegjesimit dhe aksesit ndaj informacionit per moshimin ne Shqiperi. Megjithese nuk arriti te siguronte fondet e kerkuara, projekti i skicuar nga AAGG dhe ASAG, ofroi nje mundesi per te punuar sebashku dhe per te identifikuar fusha prioritare per nderhyrje te mevoneshme. Per me teper, disa nga rekomandimet e lena nga misioni i DESA sherbyen si katalize per zhvillime te metejshme, sidomos per punen ne analizen e te dhenave dhe pergatitjen e raportit te pare mbi moshimin te publikuar nga INSTAT.

Ka tashme disa shembuj te rrjeteve nderkombetare te organizatave te shoqerise civile te cilat e perdorin MIPAA/RIS si nje baze per platformat e tyre dhe qe i koordinojne perpjekjet per te arritur progres ne shkalle rajonale: AAGG dhe rrjeti MOSHA jane pjese e nje rrjeti rajonal organizatash te Europes Juglindore nga Serbia, Maqedonia, Mali i Zi, Bosnja-Herzegovina dhe Austria nen projektin Iniciativa mbi Perfshirjen Sociale te te Moshuarve, te mbeshtetur nga Bashkimi European. Ai eshte pjese e nje rrjeti me te gjere qe fokusohet ne fushata ndergjegjesimi dhe avokatie mbi moshimin, koordinuar nga Help Age, nje organizate e rendeishme jo-qeveritare Britanike.

Ne nje rrjet tjetër rajonal, Caritas Albania, me 13 partnere nga 6 vende te rajonit te detit Adriatik, perfshire Italine, kane zbatuar projektin 'NET-AGE', nje initiative e mbeshtetur nga program IPA (BE). Projekti

Projekti synon te promovoj zhvillimin social rajonal, permes inkurajimit te rrjeteve te vullnetareve ne komunitete dhe te nxise modele te ofrimit te sherbimeve sociale shendetesore per te moshuarit. Synon gjithashtu te permiresoje koordinimin mes aktoreve publike dhe private per te shmangur barrierat ne fushen e asistences per te moshuarit.

2. Konkluzionet dhe prioritetet per te ardhmen

Up to 1,000 words (no more than two A4 pages).

This final section should contain an overall summary of the findings, future challenges and opportunities related to ageing; recommendations for future actions to be taken; and policy adjustments. Identify priorities for further policy research and indicate your country's requests, needs and wishes with regard to the work of international organizations in the field of ageing.

Ky eshte raporti i dyte i Shqiperise ne funksion te vleresimit te Planit te Madridit mbi Moshimin. Raporti i pare eshte pergatitur per raundin e pare vleresimit dhe Konferencen e Leon ne vitin 2007. Per here te pare eshte siguruar nje shkalle e larte e pjesemarrjes nga burime dhe aktore te ndryshem. Kontributet e siguruar per kete raport demostrojne se Shqiperia ka perparuar ne disa drejtime qe prej Konferences se Vienes ne vitin 2012. Dy rrethet e raportimeve te meparshem ne nivel rajonal dhe dokumenti i Konferences se Vienes, i kane dhene mundesi Shqiperise te vleresoje arritjet e bera ne keto vite dhe planifikojte nje bashkepunim akoma me intensiv ne te ardhmen.

Tranzicioni demografik i popullates Shqiptare ka ndodhur relativisht me vone krahasuar me vendet e tjera te industrializuara te rajonit ECE, por projektimi i nje moshimi te pershpjettuar te popullates dhe niveli i larte i emigrimit e kane bere te domosdoshme vendosjen e ceshtjeve te moshimit mes prioriteteve te qeverise. Ndalimi i rritjes ekonomike ne 2009 dhe renia graduale e remitancave i bejne sfidat demografike dhe ato sociale me te dukshme per Shqiperine. Megjithate, pavaresisht sfidave qe aktualisht perballon Shqiperia, qeveria e saj ka qene e angazhaur per te vijuar me permbushjen e objektiveve te aprovuar ne fushen e moshimit.

Reforma e pensioneve e parashikuar ne programin e ri qeveritar ne 2012 dhe e zbatuar ne 2014-2015 eshte me sinjifikance te vecanteper kete periudhe raportuese. Ajo merr parasysh moshimin e popullates dhe do te preke si personat aktualisht mbi 65 vjec ashtu edhe ata me te rinj. Harmonizimi i sistemit te pensioneve, rritja e lehte e moshes se pensionit si dhe futja e pensioneve sociale ofrojne nje baze te mire per stabilizimin e kontrates nder-breznore ne te ardhmen, nderkohe qe e pergatisin shoqerine per rritjen graduale te proporcionit te atyre te moshuarve qe kane ngelur jashte sistemit.

Shqiperia i ka perfshire ceshtjet e moshimit ne dokumentet kryesore te politikave te vendit sic eshte Strategjia per zhvillim dhe integrim 2015-2020, apo ne Strategjine e re te mbrojtjes dhe perfshirjes sociale 2016-2020.

Ministria e Ceshtjeve Sociale eshte e ndergjegjeshme se shumica e problemeve akute te moshimit nuk mund te zgjidhen thjesht duke ndertuar me shume qendra rezidenciale te kujdesit. Nevojitet nje qasje gjitheshtu perfshirese e shoqerise, bashkepunim nder-sektorial dhe nderhyrje ne shume nivele si ne nivel te qeverisjes qendrore ashtu edhe ne ate vendore. Nderkohe, nevojitet mbeshetje per iniciativat e qeverive vendore apo dhe te organizatave jo qeveritare ne procesin e decentralizimit. Nga ana tjeter, duke

pranuar se infrastruktura kombetare lidhur me moshimin nuk eshte shume e zhvilluar, nevojitet me shume koordinim dhe monitorim i kapaciteteve ne nivel qendror.

Nderkohe qe reforma e pensioneve do te kete nevojte per vijimesine e masave te ndermarra nga qeveria per permiresimin e veprimit te ligjit ne ekonomi, me rritjen e moshes se pensionit, do te kete nevojte per perpjekje innovative ne mbeshtetje te tregjeve te punes per te punesuarit e moshuar.

Pjesemarrja dhe perfshirja e te moshuarve ne jeten sociale do te monitorohet me mire permes targeteve dhe indikatorëve te standartizuara te perfshira ne strategjine e re te perfshirjes sociale, por per te pare ndryshim real dhe per pershpjelluar perparimin e kerkuar, Ministria e Ceshtjeve Sociale do te duhet te katalizojte dhe mbeshtese iniciativat, pjesemarrjen dhe vullnetarizmin nga ana e te moshuarve aktive, duke njohur ekspertizen e tyre ne jeten pas punesimit. Te rinjte do te duhet te drejtohen drejt bashkepunimit me intensiv me te moshuarit ne programe komunitare apo ne shkolla. Kjo do t'i jepte me shume kuptim jetes se te moshuarve dhe ne te njejten kohe e gjithë shoqeria do te perfitonte.

Reforma shendetsore po e zhvendos systemin shendetsore nga fokusimi kryesishtne problemet tradicionale shendetsore si ato te nenës dhe femijes, drejt perballimit te semundjeve kronike ne rritje dhe permiresimit te aksesit te te gjithë kategorive te popullates ne sherbimet e duhura te kujdesit shendetsor. Eshte pranuar tashme se moshimi i shoqerise i jep parandalimit dhe kapjes se hereshme nje rol thelbësor ne rritjen e cilesise se jetes, duke frenuar ne te njejten kohe rritjen e kostove mjekesore.

Programi i ri i kontrollit baze eshte nje investim per cilesi te permiresuar te jetes ne vitet e mevoneshme te adulleve te sotem, nderkohe qe eshte duke u shtrire per te perfshire te moshuarit e sotem gjithashtu, duke permiresuar aksesin e tyre ne sherbimet baze shendetsore. Nderkohe, ka nje permiresim te qarte te ndergjegjesimit per perfshirjen e sherbimeve detyrave dhe burimeve specifike dedikuar kujdesit per te moshuarit. Ne vend qe te perqendrohet ne sherbime te shtrijta te geriatrise, shoqatat e profesionistëve dhe Ministria e Shendetesise jane duke konverguar ne integrimin e sherbimeve per personat e moshuar ne sistemet ekzistuese paresore dhe dytesore, duke permiresuar standartet dhe kualifikimin e profesionistëve te shendetit.

Ministria e Shendetesise duhet te kujdeset qe ne sherbimet e kujdesit paresor, paketa e re e sherbimeve per te moshuarit te mund te monitorohet me pjesemarrjen e vete te moshuarve nderkohe qe duhet te promovohen vizitat ne shtepi per ata qe jane te izoluar dhe me veshtiresi levizjeje. Kujdesi ne familje duhet te njihet dhe te mbeshtetet me masa te kombinuara financiare, sociale apo shendetesore..

Duhet te nenvizohet fakti se informacioni dhe kerkimi mbi ceshtjet e moshimit eshte intensifikuar ne menyre te rendesishme ne Shqiperi qe prej vitit 2012. Jane perdorur kendveshtrime dhe metodologji te ndryshme qe lejojne analiza te besueshme dhe identifikimin e prioritetve sociale dhe shendetesore. Ajo cka ngelet per te ardhmen eshte mbledhja me sistematike e te dhenave dhe prodhimi i indikatorëve te standartizuar ne nivel kombetar.

Permiresimi i dukshem i infrastruktures urbane ne kuader te programit te 'Rilindjes Urbane' eshte duke i kthyer shume zona te qyteteve vegjel dhe fshatrave te Shqiperise ne vende me te mira per jetuar per te moshuarit, me trotuare me te mire, zona per kembesoret dhe parqe publik. Per te adresuar me mire izolimin, mobilitetin e keq dhe per te permiresuar aksesin ne jeten shoqerore, ky program nevojitet te ndiqet gradualisht ne te ardhmen nga masa te tilla si transport urban falas ose me kosto te ulet per qytetaret e moshuar.

Familjet me te vogla dhe prinderit e moshuar te ngelur vetem kur anetaret me te rinj kane emigruar jane nje ceshtje e rendesishme ne Shqiperi. Pervec risqeve te shtuara per me shume vulnerabilitet, kjo mund


te shihet si nje tregues i urbanizimit dhe jetes se pavarur dhe duke kercenuar rrjetet tradicionale sociale, sherben si nje nxites per inovacion dhe ofrim sherbimesh ne shoqeri. Adultet e rinj qe ndjekin mundesite per punesim, mundet ende te ofrojne mbeshtetje per prinderit e moshuar me nevoja te vecanta, nese ekzistojne sherbime te perballueshme. Institucionet shteterore mund te gjejne menyra per te mbeshteturte gjitha format e kujdesit, sidomos ato te bazuar ne familje dhe komunitet dhe te ndihmojne rregullimin me te mire te profesionit te kujdestareve per te moshuar. Kjo do te ndihmonte vec te tjerash 'moshimin ne vendndodhje', duke lejuar te moshuarit te vijojne te jetojne sa me gjate qe te jete e mundur ne mjedisin dhe komunitetin e tyre.

Shqiperia ka pasur gjate ketyre viteve nje sere fushatash sistematike avokatie mbi moshimin. Megjithese shumica e tyre kane qene ne shkalle te kufizuar, eshte siguruar pjesemarrja e qindra te moshuarve aktiviste. Ka plane per t'i bere keto fushata me efektive dhe per te permiresuar aftesite analitike dhe ato te komunikimi mes shoqatave te pensionisteve dhe perfshirjen me te madhe te profesionisteve te medias dhe qeverive vendore. Sapo eshte pergatitur nje plan strategjik nga rrjeti i shoqerise civile ne kete fushe. Gjithesesi, me teper perpjekje duhet te orientohen drejt edukimit te kategorive te ndryshme te shoqerise, sidomos te te rinjve, mbi moshimin si pjese e ciklit te jetes, duke informuar ne te njejten kohe te moshuarit mbi sfidat e brezave te rinj. Kjo do te kerkonte nje bashkepunim me te mire me Ministrine e Arsimit dhe Sporteve dhe institucione te tjera arsimore.

Se fundi, per te permiresuar ndergjegjesimin rreth imazheve pozitive te moshimit dhe per te mbeshtetur punen drejt nje shoqerie per te gjitha moshat, Shqiperia do te vazhdoje te kerkoje pjesemarrje ne perpjekjet e koordinuara nderkombetare si dhe shkembim te pervojës ne rrjetet rajonale.

Anekse

Population over 65 in Albania, 1979-2060 (in thousands)




INSTAT: Censuses 1979-2011 and projections

Employment rates distributed by age groups and sex. 2013

Sex	Age group	Employment rate (%)
Total	Total	53
	15-24	28
	25-54	76
	55-64	58
	65+	11
Men	Total	62
	15-24	37
	25-54	86
	55-64	71
	65+	15
Women	Total	44
	15-24	20
	25-54	66
	55-64	44
	65+	8


INSTAT: Labour Force Survey 2013

Working population over 65 years old by sex and by sector of work




INSTAT: Labour Force Survey 2013

Life expectancy at ages 65 and 80 in 2005-2009 and 2010-2014 (in years)




INSTAT: ageing of population: situation of older people in Albania

Elderly population 65 and over by census year and by household size




INSTAT: ageing of population: situation of older people in Albania

Percentage of elderly population over 65 years old living in an overcrowded dwelling by regions (2001-2011)




INSTAT: ageing of population: situation of older people in Albania

Self-perceived health status among people over 65 years old




Social and health situation of older people in Albania 2010. Public Health Reviews.

Different types of disability among elderly by sex (prevalence in %)




INSTAT: ageing of population: situation of older people in Albania

Prevalence of reduced mobility among people over 65 years old in Tirana and 4 other study sites (Brazil, Colombia and Canada)




IMIAS 2012

Percentage of older people 65-75 years old who are no member of any association or club. Tirana and 4 other study sites (Brazil, Colombia and Canada)



IMIAS 2012

Global Agewatch indicators for Albania 2014



Agewatch report 2014

...

...